




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Priljepljen / Predato Received / Delivered	08. 08. 2022	viti god year	
Organ / Bjesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKIPARICA	4607/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.564/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.564/2022 të datës 24.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.564/2022 e datës 24.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 15.06.2021 ka nxjerr Vendim me numër Ref.ZSP513/21 me të cilin ankuesi është caktuar përkohësisht të jetë zëvendësues i Zyrtarit Kryesor Financiar me koeficient t të pagesë nëntë (9). Ankuesi më datë 22.07.2021 ka parashtruar kërkesë tek Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes të cilës ka kërkuar që të ndryshohet niveli i koeficientit nga nëntë (9) në koeficient dhjetë (10) siç e kanë Zyrtarët Kryesor Financiar, mirëpo që nuk ka pranuar përgjigje.

Ankuesi, me datë 24.06.2022 përmes e-mailit ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 3692/2022 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor për





ndryshimin e Vendimit të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe kompensimin e mjeteve financiare sipas rangimit të pozitës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 07.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa kjo e fundit me datë 25.07.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokolli 4280/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr. protokolli 3692/2022 të datës 24.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga V.C. për B.H. i datës 22.07.2021; Vendim i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me numër protokolli 2492 i datës 16.06.2021; E-mail nga V.C. për [ankesa.kpmshek@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshek@rks-gov.net) i datës 24.06.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.07.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 4280/2022 e datës 25.07.2022; Akt Emërim i V.Ç. i datës 17.12.2018; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Konkurs me nr. reference RN00006971 i datës 07.06.2021; Vendim me nr.06/109 i datës 02.07.2019; Vendim me nr.07/12 i datës 09.07.2020; Vendim me nr.16/17 i datës 25.06.2021; Ligji nr.06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike; Ligji nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; Ligji nr.06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura; Rregullore MF-NR. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin; Flete kthesë e datës 19.07.2022

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, **është e palejuar sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që nga data 22.07.2021 kur ka paraqitur kërkesë tek Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të ndryshohet niveli i koeficientit nga nëntë (9) në koeficient dhjetë (10) siç e kanë Zyrtarët Kryesor Financiar, nuk ka pranuar përgjigje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga administrimi i provave materiale konstaton se ankuesi meqenëse nuk ka marr përgjigje nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me kërkesën e datës 22.07.2021, atëherë është dashur që brenda afateve ligjore të parashtrorë ankesë kundër heshtjes administrative, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht nenit 127 paragrafi 4, ku përcaktohet se: *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, rrjedhimisht nga administrimi i provave të lëndës, konstatohet se ankuesi përveç kërkesës së datës 22.07.2021 që e ka parashtruar përmes emailit tek Zëvendësuesi i Sekretarit të





Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nuk ka asnjë dëshmi tjetër që të ketë parashtruar kërkesë lidhur me pretendimet ankimore.

Andaj bazuar në këto rrethana meqenëse ankuesi në këtë procedurë administrative nuk ka parashtruar ankesë kundër heshtjes administrative në pajtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që nuk janë përmbushur kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, siç parashihet me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë ankesa A.nr.564/2022 e datës 24.06.2022, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e papranueshme.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.564/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Bektashi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

*Shabani*  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së